

VENDIM
Nr. 333, datë 6.6.2018

**PËR SHPALLJEN “ZONË ME PËRPARËSI ZHVILLIMI” TË “BAZËS SË TUBOVE”,
ZHUPAN, FIER, ME SIPËRFAQE 49 347 m², NË PRONËSI TË SHOQËRISË
“ALBPETROL” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 19, dhe 8, pika 3, shkronja “dh”, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vijim të pikave 4 e 5, të kreut II, të vendimit nr. 1023, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë me përparësi zhvillimi” të territorit të “Bazës së tubove”, me sipërfaqe 49 347 (dyzet e nëntë mijë e treqind e dyzet e shtatë) m², pjesë e zonës kadastrale nr. 3934, në Zhupan, Fier, në përbërje të së cilës janë parcelat me numra pasurie sipas listës në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja dhe kufijtë e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet shoqëria “Albpetrol” sh.a., të ndjekë procedurat ligjore për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë dhe të bëjë zhvendosjen e pasurive të luajtshme, që ndodhen në këtë zonë.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqëria “Albpetrol” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

SHTOJCA NR. 1

LISTA E PASURIVE PJESË PËRBËRËSE TË “BAZËS SË TUBOVE”, ZHUPAN, FIER

Nr.	Zona kadastrale	Vendndodhja	Nr. i pronës	Sipërfaqe trualli (m ²)	Sipërfaqe objekti (m ²)
1	3934	Zhupan, Fier	115/84	12,000	43
2	3934	Zhupan, Fier	115/29	230	230
3	3934	Zhupan, Fier	115/13	96	96
4	3934	Zhupan, Fier	115/30	264	264
5	3934	Zhupan, Fier	115/14	611	611
6	3934	Zhupan, Fier	115/15	147	147
7	3934	Zhupan, Fier	115/16	1,153	1,153
8	3934	Zhupan, Fier	115/31	208	208
9	3934	Zhupan, Fier	115/32	191	191
10	3934	Zhupan, Fier	115/117	21,441	1,842
11	3934	Zhupan, Fier	115/33	383	383
12	3934	Zhupan, Fier	115/56	109	109
13	3934	Zhupan, Fier	115/82	12,514	1,140
			TOTAL	49,347	6,417

**PLAN VENDOSJE E "BAZES SE TUBOVE" NE ZK 3934 ZHUPAN
NE PRONESI TE SHOQERISE "ALBPETROL Sha " Shk.1:1000
SIPERFAQJA E TRUALLIT 49347 M2
SIPERFAQJA E OBJEKTEVE 6417 M2**

